



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr. 1729, datë 20.12.2011

Për

“Miratimin e Dokumentit për këshillim publik “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregullore Nr. 13, datë 16. 04. 2010 “Për Portabilitetin e Numrit””

Këshilli Drejtues (*KD*) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*AKEP*), i përbërë nga:

1.	Z.	Piro	Xhixho	Kryetar
2.	Z.	Alban	Karapici	Anëtar
3.	Znj.	Alketa	Mukavelati	Anëtar
4.	Z.	Benon	Paloka	Anëtar
5.	Znj.	Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 20.12.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, mori në shqyrtim, çështjen me objekt:

“Miratimin e Dokumentit për këshillim publik “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregullore Nr. 13, datë 16. 04. 2010 “Për Portabilitetin e Numrit””

BAZA LIGJORE:

1. Shkronja p) e nenit 8, nenet 87, 88 dhe 110 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*);
2. Kodi i Procedurës Administrative (*KprA*);
3. Rregullore Nr. 13, datë 16.04.2010 për “Portabilitetin e Numrit”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1219, datë 07.04.2010 (*Rregullore*);

4. Pika 17 e nenit 21 “Rregullores së Brendëshme të AKEP (ish ERT)” (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues (VKD) të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

- Relacioni shpjegues mbi Projektaktin : “Për disa shtesa dhe ndryshime në “Rregulloren Nr. 13, datë 16. 04. 2010, “Për Portabilitetin e Numrit”, miratuar me VKD nr. 1219, datë 07. 04. 2010 – Dokument për këshillim publik””
- Dokumenti për këshillim publik
- Projektvendim i KD i formatuar dhe arsyetuar;

si dhe,

- Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen;

Duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E H E T se :

1. Grupi i punës sipas Urdhër Nr. 769, datë 17. 11. 2011 “Për ngritje grup-pune” me qëllim: *Rishikimin e Rregullores Nr. 13, datë 16. 04. 2010 “Për Portabilitetin e Numrit”, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 1219, datë 07. 04. 2010, në funksion të zgjidhjes së disa problemeve që janë evidentuar gjatë ofrimit të shërbimit të portabilitetit të numrit, si:*

- Përqindjen e pranimit të kërkesave për bartje;
- Problemet me thirrjet ndërkombëtare;
- Nivelin e bashkëpunimit midis operatorëve etj.,

ka paraqitur për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e Këshillit Drejtues, Dokumentin për Këshillim Publik “ Për disa shtesa dhe ndryshime në “Rregulloren Nr. 13, datë 16. 04. 2010, “Për Portabilitetin e Numrit”, miratuar me VKD nr. 1219, datë 07. 04. 2010””.

2. Duke marrë në konsideratë çështjet e diskutuara me sipërmarrësit e komunikimeve elektronike në takimet e kryera nga AKEP-i më datë 02. 11. 2011 me katër operatorët e telefonisë mobile, dhe më datë 08. 11. 2011 me përfaqësuesit e katër operatorëve të telefonisë mobile, Albtelecomit dhe operatorëve alternativë, konkluzionet e arritura në këto takime, si dhe shkresat e dërguara në AKEP nga këta sipërmarrës, pas rreth 6 muaj nga fillimi i ofrimit të shërbimit të Portabilitetit të dhe bartjes së numrave për telefoninë e lëvizshme evidentohen disa probleme shqetësuese lidhur me zbatimin e tij, që çojnë në:

- përqindje të lartë të mospranimit të kërkesave të pajtimtarve për bartje;
- raste të bllokimit të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare.

Arsyet që çojnë në ekzistencën e kësaj problematike lidhen kryesisht me faktin që:

- Të dhënat e pajtimtarëve në bazat e të dhënave të sipërmarrësve (operatorëve) nuk janë plotësisht të sakta.

Kjo bën që mospranimi i kërkesave për bartje nga ana e operatorëve dhënës (ose donor) të vijë kryesisht për këtë arsye. Duke u nisur nga raportet e gjeneruara nga sistemi i CRDB si dhe ankesat e ardhura në AKEP nga ana e operatorëve të tjerë, probleme me të

dhënat e pajtimtarëve kanë më shumë operatorët të cilët bazat e të dhënave të pajtimtarëve i kanë të pa përditësuara prej disa vitesh.

- Operatorët alternative apo dhe operatorë të cilët bëjnë rrugëzim thirrjesh ndërkombëtare, në disa raste bëjnë rrugëzim të gabuar të thirrjes, për shkak se mënyra manuale e zgjedhur nuk përdoret rregullisht, apo nxjerrjes së problemeve nga ana e platformave të këtyre operatorëve, të cilat në shumicën e rasteve janë të një teknologjie relativisht të vjetër.

- Bashkëpunimi i operatorëve me njeri-tjetrin në procese të tilla është shumë i rëndësishëm. Në shumicën e rasteve, kur ka patur nevojë për shkëmbim apo përditësim të të dhënave të abonentëve, bashkëpunimi i operatorëve ka qenë i një niveli të kënaqshëm por nuk kanë munguar dhe rastet kur procesi është zvarritur nga operatorët dhënës (apo *donor*).

3. Për zgjidhjen e problemeve të evidentuara edhe më sipër, nga pikpamja rregullatore mendohet se duhen normuar në mënyrë detyruese disa aspekte si të karakterit teknik ashtu dhe ato të marrëdhënieve midis sipërmarrësve me njeri-tjetrin dhe të sipërmarrësve me pajtimtarët e tyre. Për këtë rekomandohen disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren Nr. 13, datë 16. 04. 2010 “Për Portabilitetin e Numrit”, si dhe marrja e disa vendimeve administrative.

Ndërhyrja në rregullore do të shërbejë për moslejimin e fenomenit të mosbashkëpunimit ndërmjet sipërmarrësve dhe normimin teknik të automatizimit të procesit nga ana e të gjithë sipërmarrësve të autorizuar për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike të telefonisë fikse dhe ato të terminimit të thirrjeve.

Nxjerrjave e disa rregullimeve nëpërmjet vendosjes së disa detyrimeve në aktin administrativ vendimmarrës do të shërbejë për vendosjen e afateve të realizimit të këtyre detyrimeve nga ana e sipërmarrësve.

4. Me qëllim eliminimin e çdo premise për keqkuptim ose keqinterpretim, si dhe për shkakun se ky kusht parashikohet në kontratat e sipërmarrësit me pajtimtarin të cilat sipas pikës 5 të nenit 99 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*) hartohen nga sipërmarrësit dhe miratohen nga AKEP-i, konsiderohet e panevojshme vendosja e kohëzgjatjes minimale të kontratës në këtë rregullore.

Për këtë rekomandohet:

- Në pikën 5 të nenit 4 të Rregullores **të hiqet** fjalia “*Kohëzgjatja e kontratës duhet të jetë jo më pak se 6(gjashtë) muaj*”.

5. Për të njëjtat arsye të cituara në pikën 1 të mësipërme, rekomandohet:

- Në pikën 6 të nenit 5 të Rregullores **të hiqet** togfjalëshi brenda kllapave në rreshtin e katërt “ (*neni 4 pika 5 e kësaj rregulloreje*).

6. Me qëllim realizimin e detyrueshëm të automatizimit të procesit të përditësimit nga të gjithë sipërmarrësit pa përjashtim, të cilët rrugqzojnë thirrje ndërkombëtare, rekomandohet:

- Pika 1 e nenit 7 të Rregullores të ndryshojë dhe bëhet:

“1. Të gjithë operatorët e rrjeteve publike telefonike ose shërbimeve telefonike, të disponueshme për publikun, nëpërmjet automatizimit të plotë të procesit duhet të mbështesin rrugëzimin e thirrjeve në numra të bartur gjeografikë dhe të lëvizshëm. Mënyra e përzgjedhur e rrugëzimit është “all call query-kërkimi për çdo thirrje”.

7. Për të ulur në maksimum përqindjen e lartë të mospranimit të kërkesave për bartje për shkak të mospërditësimit të të dhënave të pajtimtarit të regjistruara në bazën e të dhënave të sipërmarrësit, rekomandohet:

- Pika 3 e nenit 14 të Rregullores të ndryshojë dhe bëhet:

“3. Baza e të dhënave referencë e centralizuar menjëherë kontrollon saktësinë e kërkesës për bartje sa më shpejt të jetë e mundur, në veçanti nëse numri i cili do të bartet është numër gjeografik ose i lëvizshëm dhe nëse numri është saktësisht i vendosur në rrjetin e operatorit dhënës. Në rast se zbulohet ndonjë gabim, baza e të dhënave referencë e centralizuar menjëherë i dërgon mesazh për gabimin operatorit marrës. marrës është i detyruar që në bashkëpunim me operatorin dhënës dhe pajtimtarin të kryejnë, brenda afateve të percaktuara në këto rregullore, korrigjimin e gabimit të konstatuar në kërkesën për bartje”.

- Në pikën 2 të nenit 15, pas paragrafit të fundit të shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Në raste të përgjigjes negative sipas kësaj dispozite, operatori dhënës është i detyruar të bashkëpunojë me pajtimtarin dhe operatorin marrës për të mundësuar korrigjimin e gabimit të konstatuar me qëllim realizimin e procesit të bartjes së numrit brenda afateve të percaktuara në këtë rregullore”.

- Pika 2 e nenit 17 të rregullores të ndryshojë dhe bëhet:

“2. Nëse kërkesa për bartje nuk mund të zgjidhet nëpërmjet shkëmbimit të mesazheve standarde elektronike, personi i kontaktit i operatorit marrës do të kontaktojë drejtpërdrejtë personin e kontaktit të operatorit dhënës të diskutojë një zgjidhje të mundshme. Duke respektuar parimin "one-stop-shop" të bartjes së numrit, operatorët duhet të gjejnë një zgjidhje brenda 8 orëve pune duke shkëmbyer dhe përditësuar të dhënat e sakta në interes të pajtimtarit dhe vazhdimit të procesit të bartjes”.

8. Me qëllim realizimin e detyrueshëm të automatizimit të procesit të përditësimit nga të gjithë sipërmarrësit pa përjashtim, të cilët rrugqzojnë thirrje ndërkombëtare, rekomandohet:

- Shkronja b) e pikës 2 të nenit 19 të ndryshojë dhe bëhet:

“b) Operatorët me nën 100.000 pajtimtarë janë të detyruar të fillojnë të përdorin bazën e të dhënave referencë të centralizuar për importimin dhe eksportimin e numrave dhe rrugëzimin e thirrjeve, jo më vonë se një muaj pas themelimit dhe testimit të bazës së të dhënave referencë të centralizuar.

Këta operatorë, sipas afateve të përcaktuara nga AKEP-i, gjithashtu janë të detyruar të aplikojnë automatizimin e plotë të procesit të përditësimit të bazës së të dhënave referencë të centralizuar pasqyrë për rrugëzimin e thirrjeve”.

9. Rekomandohet që tek Shtojca e Rregullores “Kërkesa për bartjen e numrit”, pika 1 e deklaramentit të pajtimtarit të ndryshojë dhe bëhet:

“ 1. Aktualisht përdor numrin/numrat e përmendur të telefonit në rrjetin e operatorit dhënës, kam njoftuar ndryshimin e të dhënave të mia të regjistruara tek baza e të dhënave të këtij operatori (nëse ka patur ndryshime të tilla), dhe dëshiroj të anulloj kontratën me operatorin dhënës për këto numra”.

10. Në aktin administrativ vendimmarrës propozohet që të përcaktohet:

- A) Afati i realizimit të përditësimit të të dhënave të pajtimtarëve nga sipërmarrësit. Ky afat të jetë deri në 3(tre) muaj nga data e miratimit të aktit nga ana e Këshillit Drejtues të AKEP-it.
- B) Afati i realizimit të procesit të automatizimit të plotë të procesit të përditësimit të bazës së të dhënave referencë të centralizuar pasqyrë për rrugëzimin e thirrjeve, nga të gjithë sipërmarrësit pa përjashtim. Ky afat të jetë deri në 3(tre) muaj nga data e miratimit të aktit nga ana e Këshillit Drejtues të AKEP-it.
- C) Afati i realizimit të ofrimit të shërbimit të portabilitetit të numrit nga të gjithë operatorët që ofrojnë shërbim të telefonisë publike. Ky afat të jetë deri më 30 Qershor 2012.

11. Ndërhyrjet e propozuara në Rregulloren Nr. 13, datë 16. 04. 2010 “Për Portabilitetin e Numrit” meqenëse përbëjnë një dokument rregullator me ndikim të ndjeshëm në tregun e komunikimeve elektronike, rekomandohet marrja dhe vlerësimi i mendimit të palëve të interesuara nëpërmjet këshillimit publik sipas nenit 110 të ligjit nr. 9918.

12. Nga pikëpamja thelbësore propozimi është përgatitur bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës.

Nga pikëpamja formale proceduriale, dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me përcaktimet e parashikuara në Rregulloren e Brendshme të AKEP.

13. Ndërhyrja në Rregullore i shërben qëllimit të përmirësimit të kuadrit rregullator për ofrimin e shërbimit të Portabilitetit të Numrit dhe eliminimit të problemeve të evidentuara.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në:

1. Kodin e Procedurave Administrative;
2. Shkronjën p) të nenit 8 dhe nenet 87, 88 dhe 110 te ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “ Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”;
3. Pikën 17 të nenit 21 “Rregullores së Brendëshme të AKEP (ish ERT)” , miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues (VKD) të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;

V E N D O S:

1. Miratimin e Dokumentit rregullator “ Për disa shtesa dhe ndryshime në “Rregulloren Nr. 13, datë 16. 04. 2010, “Për Portabilitetin e Numrit”, miratuar me VKD nr. 1219, datë 07. 04. 2010 – Dokument për këshillim publik””, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi, dhe zbatimin e procesit të këshillimit publik sipas nenit 110 të ligjit nr. 9918.
2. Procesi i keshillimit publik fillon me date 23. 12. 2011 dhe përfundon më datë 23.01. 2012.

Ky vendim hyn në fuqi menjëhere.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI** _____
2. **Alketa MUKAVELATI** _____
3. **Benon PALOKA** _____
4. **Zamira NURÇE** _____

DOKUMENTI PËR KËSHILLIM PUBLIK

Për

“Disa shtesa dhe ndryshime në “Rregulloren Nr. 13, datë 16. 04. 2010, “Për Portabilitetin e Numrit”, miratuar me VKD nr. 1219, datë 07. 04. 2010”” dhe “Përcaktime në aktin administrativ vendimmarrës”.

1. Në pikën 5 të nenit 4 të Rregullores të hiqet fjalia “Kohëzgjatja e kontratës duhet të jetë jo më pak se 6(gjashtë) muaj”.

2. Në nenin 4 të Rregullores, pas pikës 6 të shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Pajtimtarët janë të detyruar që të njoftojnë sipërmarrësin me të cilin kanë lidhur kontratën e pajtimit, për çdo ndryshim të të dhënave të tyre të rregjistruara në bazën e të dhënave të sipërmarrësit”.

3. Në pikën 6 të nenit 5 të Rregullores të hiqet togfjalëshi brenda kllapave në rreshtin e katërt “ (neni 4 pika 5 e kësaj rregulloreje).

4. Pika 1 e nenit 7 të Rregullores të ndryshojë dhe bëhet:

“1. Të gjithë operatorët e rrjeteve publike telefonike ose shërbimeve telefonike, të disponueshme për publikun, **nëpërmjet automatizimit të plotë të procesit** duhet të mbështesin rrugëzimin e thirrjeve në numra të bartur gjeografikë dhe të lëvizshëm. Mënyra e përzgjedhur e rrugëzimit është “all call query-kërkimi për çdo thirrje”.

5. Pika 3 e nenit 14 të Rregullores të ndryshojë dhe bëhet:

“3. Baza e të dhënave referencë e centralizuar menjëherë kontrollon saktësinë e kërkesës për bartje sa më shpejt të jetë e mundur, në veçanti nëse numri i cili do të bartet është numër gjeografik ose i lëvizshëm dhe nëse numri është saktësisht i vendosur në rrjetin e operatorit dhënës. Në rast se zbulohet ndonjë gabim, baza e të dhënave referencë e centralizuar menjëherë i dërgon mesazh për gabimin operatorit marrës. **Operatori marrës është i detyruar që në bashkëpunim me operatorin dhënës dhe pajtimtarin të kryejnë brenda një afati sa më të shkurtër korrigjimin e gabimit të konstatuar në kërkesën për bartje**”.

6. Në pikën 2 të nenit 15, pas paragrafit të fundit të shtohet paragrafi me këtë përmbajtje: “ **Në raste të përgjigjes negative sipas kësaj dispozite, operatori dhënës është i detyruar të bashkëpunojë me pajtimtarin dhe operatorin marrës për të mundësuar korrigjimin e gabimit të konstatuar me qëllim realizimin e procesit të bartjes së numrit brenda afateve të përcaktuara në këtë rregullore**”.

7. Pika 2 e nenit 17 të rregullores të ndryshojë dhe bëhet:

“2. Nëse kërkesa për bartje nuk mund të zgjidhet nëpërmjet shkëmbimit të mesazheve standarde elektronike, personi i kontaktit i operatorit marrës do të kontaktojë drejtpërdrejtë personin e kontaktit të operatorit dhënës të diskutojë një zgjidhje të mundshme. **Duke respektuar parimin "one-stop-shop" të bartjes së numrit, operatorët duhet të gjejnë një zgjidhje brenda 8 orëve pune duke shkëmbyer dhe përditësuar të dhënat e sakta në interes të pajtimtarit dhe vazhdimin të procesit të bartjes**”.

8. Shkronja b) e pikës 2 të nenit 19 të ndryshojë dhe bëhet:

“b) Operatorët me nën 100.000 pajtimtarë janë të detyruar të fillojnë të përdorin bazën e të dhënave referencë të centralizuar për importimin dhe eksportimin e numrave dhe rrugëzimin e thirrjeve, jo më vonë se një muaj pas themelimit dhe testimit të bazës së të dhënave referencë të centralizuar.

Këta operatorë, sipas afateve të përcaktuara nga AKEP-i, gjithashtu janë të detyruar të aplikojnë automatizimin e plotë të procesit të përditësimit të bazës së të dhënave referencë të centralizuar pasqyrë për rrugëzimin e thirrjeve”.

9. Tek Shtojca e Rregullores “Kërkesa për bartjen e numrit”, pika 1 e deklaramentit të pajtimtarit të ndryshojë dhe bëhet:

“ 1. Aktualisht përdor numrin/numrat e përmendur të telefonit në rrjetin e operatorit dhënës, kam njoftuar ndryshimin e të dhënave të mia të regjistruara tek baza e të dhënave të këtij operatori (nëse ka patur ndryshime të tilla), dhe dëshiroj të anuloj kontratën me operatorin dhënës për këto numra”.

10. Në aktin administrativ vendimmarrës të përcaktohet:

- A) Afati i realizimit të përditësimit të të dhënave të pajtimtarëve nga sipërmarrësit. Ky afat të jetë deri në 3(tre) muaj nga data e miratimit të aktit nga ana e Këshillit Drejtues të AKEP-it.
- B) Afati i realizimit të procesit të automatizimit të plotë të procesit të përditësimit të bazës së të dhënave referencë të centralizuar pasqyrë për rrugëzimin e thirrjeve, nga të gjithë sipërmarrësit pa përjashtim. Ky afat të jetë deri në 3(tre) muaj nga data e miratimit të aktit nga ana e Këshillit Drejtues të AKEP-it.
- C) Afati i realizimit të ofrimit të shërbimit të portabilitetit të numrit nga të gjithë operatorët që ofrojnë shërbim të telefonisë publike. Ky afat të jetë deri më 30 Qershor 2012.

Shpjegues për këshillimin publik

Ky këshillim realizohet për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren për Portabilitetin e Numrit e cila është miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1219, datë 07.04.2010.

Portabiliteti i numrit është me rëndësi për të gjithë operatorët të cilët përdorin numra gjeografikë dhe/ose numra të lëvizshëm në rrjetet e tyre. Ka ndikim tek të gjithë operatorët të cilët i rrugëzojnë thirrjet në numra gjeografikë dhe/ose në numra të lëvizshëm. Edhe nëse operatori nuk ka as edhe një numër të vetëm të bartur në rrjetin e tij, ai përsëri do të duhet të mundësojë me sukses rrugëzimin e thirrjeve dalëse tek numrat e bartur.

AKEP, ka për qëllim të realizojë zgjidhje që:

- do të kontribuojnë ndaj konkurrencës, në veçanti duke e bërë të lehtë dhe të shpejtë për bartjen e një numri nga një rrjet tek tjetri;
- sjellin përfitime më të mëdha për abonentët dhe që mbrojnë interesat e abonentëve dhe përdoruesve të tjerë fundorë, në veçanti në lidhje me transparencën e tarifave;
- janë neutrale nga pikëpamja e teknologjisë dhe që funksionojnë si në rrjetet klasike të telefonisë (PSTN) dhe në rrjetet e gjeneratës tjetër (VoIP, NGN);

- janë plotësisht në përputhje me legjislacionin aktual të BE-se.

AKEP-i fton të gjithë operatorët të përgjigjen këtij këshillimi.